

VENDIM
Nr.12, datë 15.4.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	anëtar i “ “
Petrit Plloçi	anëtar i “ “
Sokol Sadushi	anëtar i “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Admir Thanza	anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datat 7.10.2010 dhe 21.10.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 20/5 Akti që i përket:

KËRKUES: Dimitris Peitsidis, përfaqësuar nga avokati Ilir Shuraja, me prokurë

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

- Rezarta Jorgji

- zyra e përmbarimit Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI: 1. Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

2. Dënimi me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë të subjektit të interesuar, Rezarta Jorgji, në rast moszbatimi ose pengimi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës europiane për të drejtat e njeriut; nenet 510 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (i ndryshuar); nenet 27, 28, 29, 30, 31, 72, 81/4 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha; përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës; subjektin e interesuar, Rezarta Jorgji, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Me vendimin nr.9523/2008 të Gjykatës Njëanëtarëshe të Shkallës së Parë, Selanik, kërkuarit i është njohur e drejta e komunikimit me fëmijën e mitur, djalin AP, lindur më 6.10.2000. Subjekti i interesuar, RJ, së bashku me djalin është kthyer dhe jeton në Shqipëri prej datës 14.6.2008.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.120, datë 13.11.2008, ka njohur vendimin nr.9523/2008 të Gjykatës Njëanëtarëshe të Shkallës së Parë, Selanik, duke i dhënë fuqi ligjore për zbatim edhe në territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.143, datë 26.12.2008, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin nr.120, datë 13.11.2008.

Urdhri i ekzekutimit është vënë në ekzekutim nga zyra e përmbarimit Tiranë për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi i formës së prerë (titulli ekzekutiv). Përmbaruesi gjyqësor ka filluar procedurën me lajmërimin e subjektit të interesuar për ekzekutimin vullnetar dhe më pas për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të formës së prerë. Zyra e përmbarimit ka vendosur, gjithashtu, gjobitjen e subjektit të interesuar në shumën 30 000 lekë (shkresa nr.3973 prot., datë 20.3.2009) dhe në shumën 50 000 lekë (shkresa nr.13252 prot., datë 13.9.2010). Gjithashtu, në referim të nenit 320 të Kodit Penal (KP), Zyra e Përmbarimit, me shkresën nr.13271 prot., datë 13.9.2010, ka paraqitur kallëzim për ndjekjen penale të subjektit të interesuar për pengim të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesën me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe dënimin me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë të subjektit të interesuar, në rast moszbatimi ose pengimi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se si përmbaruesi gjyqësor, i cili nuk ka ushtruar të gjitha kompetencat e parashikuara nga ligji, ashtu dhe subjekti i interesuar që ka paraqitur urdhrat e mbrojtjes, të lëshuara nga gjykata si pengesa artificiale, kanë shkaktuar mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda afatit të arsyeshëm.

Subjekti i interesuar, RJ, prapësoi si vijon:

- Kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, pasi ekzekutimi i vendimit të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 i Gjykatës së Apelit Tiranë është atribut i Zyrës së Përmbarimit dhe nuk përbën çështje për t'u gjykuar nga juridiksioni kushtetues.

- Pretendimi i kërkuesit për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë është i pabazuar, pasi ai është takuar rregullisht me fëmijën, në përputhje me vendimin e gjykatës, me kërkesat e zyrës së përmbarimit, si edhe në prani të psikologes.

- Pretendimi i kërkuesit për vënien e gjobës është i pabazuar dhe duhet rrëzuar, pasi nuk është kompetencë e Gjykatës Kushtetuese, por e gjykatës së zakonshme.

II

1. Në lidhje me legjitimitimin e kërkuesit

Subjekti i interesuar ka pretenduar se kërkuesi nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi ekzekutimi i vendimit të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 i Gjykatës së Apelit Tiranë nuk përbën çështje për t'u gjykuar nga juridiksioni kushtetues, por është në kompetencë të zyrës së përmbarimit Tiranë.

Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkuesit lidhet drejtpërdrejt me iniciimin e një procesi kushtetues. Individidi, në kuptim të neneve 131, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "g" dhe pika 2 të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.6, datë 31.3.2006; nr.27, datë 20.6.2007; nr.1, datë 19.1.2009*).

Gjykata është shprehur se nenet 42, 142/3 të Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës europiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ) nënvizojnë faktin se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.6, datë 31.3.2006; nr.6, datë 6.3.2009; nr.35, datë 27.10.2010*).

Bazuar në jurisprudencën e mësipërme kushtetuese dhe në rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm është element i procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Në këtë vështrim, Gjykata, në kuptim të nenit 131, shkronja "f" e Kushtetutës, vlerëson se çështja objekt shqyrtimi përfshihet në rrethin e çështjeve të juridiksionit kushtetues dhe se kërkuesi, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, legjitimohet të vërë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

Përsa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i subjektit të interesuar për moslegjitimin e kërkuesit, mbështetur në argumentin se ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë i takon zyrës së përmbarimit, dhe jo Gjykatës Kushtetuese, është haptazi i pabazuar.

2. Lidhur me pretendimin e kërkuesit për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm

Gjykata ka vlerësuar se ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, por detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës është konsideruar si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht, sepse vetëm pas realizimit të saj mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar (*shih vendimet e*

Gjykatës Kushtetuese nr.43, datë 19.12.2007; nr.1, datë 19.1.2009; nr.6, datë 6.3.2009; nr.6, datë 4.3.2010).

Gjykata rikonfirmon qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.1, datë 19.1.2009; nr.9, datë 1.4.2009; nr.8, datë 23.3.2010, nr.14, datë 15.4.2010*).

i) Lidhur me kompleksitetin e çështjes

Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.1, datë 19.1.2009; nr.9, datë 1.4.2009; nr.8, datë 23.3.2010, nr.14, datë 15.4.2010*).

Në rastin konkret, objekti i çështjes të vënë në ekzekutim ka të bëjë me të drejtën e kërkuesit për të komunikuar me fëmijën e tij, sipas urdhërimeve të mëposhtme: "...takimin e fëmijës me babain çdo fundjavë të dytë të muajit, nga e premja në darkë deri të dielën pasdite; javët gjatë të cilave në fundjavë i mituri do jetë me nënën, çdo të mërkurë dhe të premte nga ora 19.30-21.30; gjatë festave të Krishtlindjeve dhe të Vitit të Ri me alternim, d.m.th. për Krishtlindje do ta ketë të miturin kërkuesi dhe për Vitin e Ri nëna dhe, në vitin pasardhës, anasjellas; në festat e ditëlindjes dhe të ditës së emrit të të miturit vlejnë të njëjtat parashikime si për festat e Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri, d.m.th. në mënyrë të alternuar, vitin e parë për ditëlindjen e tij do të qëndrojë me të atin dhe në ditën e emrit me të ëmën, kurse vitin pasardhës, anasjellas; çdo verë nga data 1 korrik deri në 15 gusht kërkuesi do të marrë fëmijën nga shtëpia e të ëmës dhe do ta kthejë në të njëjtin vend ai vetë personalisht ose ndonjë person që ka besimin edhe të së ëmës së tij...".

Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative ose organet legjislativë, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore. E drejta e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit (edhe kur prindërit banojnë në shtete të ndryshme), që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës duhet, respektuar nga shteti (*shih nenet 3, 9/3 dhe 10/2 të Konventës mbi të drejtat e fëmijës*).

Gjykata konstaton se gjatë procesit të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, subjekti i interesuar ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi, si rezultat i lëshimit të një urdhri mbrojtjeje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu, ka parashtruar pretendime ndaj urdhërimeve të zyrës së përmbarrimit për takimin e fëmijës me kërkuesin në ditët kur ai është në shkollë dhe në mjedise të tjera të papërshtatshme, se kërkuesi nuk ka një banesë të përhershme në Tiranë, si dhe mospagimin nga ana e tij të detyrimit ushqimor.

Gjykata vlerëson se pretendimet e mësipërme të subjektit të interesuar kanë të bëjnë me kohën, mënyrën dhe vendin e takimit të kërkuesit me fëmijën e mitur dhe jo me kundërshtimin e titullit ekzekutiv ose efektet e vendimit të formës së prerë. Natyra e fakteve të kundërshtuara nuk përbën arsye të justifikuar për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

Gjykata vlerëson se natyra e urdhërimeve të vendimit të formës së prerë, të cilat janë të vazhdueshme/periodike dhe në funksion të sigurimit të interesit të të miturit dhe mirëqenies së tij në të gjitha aspektet, e bëjnë çështjen komplekse. Kjo përbën një arsye më shumë për zbatimin dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga vendimi i formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm dhe jo për mosekzekutimin e vendimit.

ii) Lidhur me interesin dhe sjelljen e kërkuesit

Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se vlerësimi i sjelljes dhe i interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke nënvizuar se përdorimi nga ana e kërkuesit të të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.1, datë 19.1.2009; nr.9, datë 1.4.2009; nr.8, datë 23.3.2010, nr.14, datë 15.4.2010*).

Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi ka depozituar pranë zyrës së përmbarrimit Tiranë kërkesën

për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë në datën 7.1.2009. Po ashtu, kërkuesi i është drejtuar edhe subjektit të interesuar me shkresat e datave 2.12.2008, 8.1.2009, 31.3.2009. Kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë duke kundërshtuar dy urdhrat e mbrojtjes të lëshuara në favor të subjektit të interesuar, të cilat janë anuluar me vendimet nr.89, datë 4.3.2009 dhe nr.366, datë 10.11.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjithashtu, në datën 10.8.2010 kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal ndaj subjektit të interesuar për pengimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, si dhe kundër zyrës së përmbaarimit Tiranë për veprat penale “të mosekzekutimit pa shkaqe të përligjura të vendimit të gjykatës” dhe “të shpërdorimit të detyrës”.

Gjykata vlerëson se interesi i kërkuesit në rastin konkret është i dukshëm dhe real, pasi bëhet fjalë për garantimin e raportit prind – fëmijë. Përsa i përket sjelljes së kërkuesit, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që sjelljet e kërkuesit të kenë qenë shkak kryesor për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

iii) Lidhur me sjelljen e subjektit të interesuar

Subjekti i interesuar në datën 15.1.2009, në përgjigje të urdhërimeve të zyrës së përmbaarimit, ka kërkuar pezullimin e procedurës së ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, si rezultat i një urdhri mbrojtjeje lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (i cili ka qenë në fuqi nga data 12.1.2009 deri në datën 4.3.2009) me vendimin nr.6937, datë 22.7.2008, që ka urdhëruar kërkuesin, midis të tjerash, të mos i afrohej fëmijës së tij për një periudhë njëvjeçare që fillonte nga data e paraqitjes së kërkesëpadisë më 17.7.2008 deri në 17.7.2009. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.89, datë 4.3.2009, ka ndryshuar vendimin e mësipërm, duke rrëzuar padinë (anulimin e urdhrit të parë të mbrojtjes). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.6286, datë 13.7.2009, ka vendosur përsëri lëshimin e urdhrit të mbrojtjes për RJ-në dhe fëmijën e saj, për periudhën kohore nga 13.7.2009 deri më 13.3.2010. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.366, datë 10.11.2009, ka ndryshuar vendimin e mësipërm, duke rrëzuar sërish padinë (anulimin e urdhrit të dytë të mbrojtjes).

Gjykata vlerëson se subjekti i interesuar, RJ, nuk ka treguar vullnet të mjaftueshëm për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë që nga momenti i lëshimit të urdhrit të ekzekutimit të vendimit e në vazhdim.

Në përfundim të analizës së sjelljes të kërkuesit dhe të subjektit të interesuar, Gjykata vlerëson se të dyja palët i kanë pasur të gjitha mundësitë për të arritur një marrëveshje për zbatimin e vendimit të formës së prerë ose për ndryshimin e tij në interesin më të lartë të fëmijës së tyre të mitur.

iv) Lidhur me sjelljen e autoriteteve përgjegjëse

Gjykata ka nënvizuar vazhdimisht se në fazën e ekzekutimit të vendimeve marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.6, datë 4.3.2010*).

Lidhur me sjelljen e autoriteteve përgjegjëse, në rastin konkret të përmbaaruesit gjyqësor, i cili, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv, Gjykata vlerëson se është e nevojshme të vlerësohet nëse ky autoritet ka marrë ose jo masat e nevojshme për zbatimin e urdhrit të ekzekutimit, në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe, në këtë mënyrë të vlerësohet nëse veprimet ose mosveprimet e tij janë në përputhje me urdhërimet e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Zyra e përmbaarimit ka vënë në ekzekutim vendimin nr.120, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë sipas urdhrit të ekzekutimit të lëshuar me vendimin nr. 143, datë 26.12.2008 po të kësaj Gjykate. Me shkresën nr.362 prot., datë 12.1.2009, zyra e përmbaarimit ka njoftuar RJ-në për të përmbushur vullnetarisht detyrimet që rrjedhin nga vendimi i formës së prerë (titulli ekzekutiv). Zyra e përmbaarimit ka vazhduar procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të formës së prerë, duke urdhëruar subjektin e interesuar me shkresat nr.1606 prot., datë 4.2.2009; nr.1877 prot., datë 10.2.2009; nr.2917 prot., datë 2.3.2009; nr.3974 prot., datë 20.3.2009; nr.4610 prot., datë 31.3.2009; nr.5449 prot., datë 15.4.2009. Gjatë procesit të ekzekutimit, Zyra e Përmbaarimit ka vendosur, gjithashtu, gjobitjen e subjektit të interesuar në shumën 30 000 lekë (shkresa nr.3973 prot., datë 20.3.2009) dhe në shumën 50 000 lekë (shkresa nr.13252 prot., 13.9.2010). Me shkresën nr.13271

prot., datë 13.9.2010 zyra e përmbarimit, në referim të nenit 320 të Kodit Penal, ka paraqitur kallëzim për ndjekjen penale të subjektit të interesuar për pengim të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë. Gjithashtu, për ekzekutimin e vendimit, zyra e përmbarimit ka kërkuar vazhdimisht bashkëpunimin me komisaritet e policisë. Si rezultat, kërkuesi është takuar me fëmijën, në prani të psikologes, vetëm në 9 (nëntë) raste, takime të cilat kanë pasur një kohëzgjatje të kufizuar dhe në mjedise të papërshtatshme dhe të ndryshme nga ato që përcakton shprehimisht vendimi gjyqësor.

Nga tërësia e rrethanave faktike të mësipërme, Gjykata vlerëson se zyra e përmbarimit Tiranë nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008. Ndonëse përmbaruesi gjyqësor është përpjekur të ndërmarrë hapat e nevojshëm proceduralë, për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimit, këto përpjekje kanë qenë të pasuksesshme, pasi mënyra, koha dhe vendi i takimit të kërkuesit me fëmijën në asnjë rast nuk ka qenë në përputhje me urdhërimet e dispozitivit të vendimit të formës së prerë. Gjithashtu, vihen re ndërprerje të pajustificuara dhe të paarsyeshme të veprimeve përmbarimore dhe përmbushje të pjesshme të detyrimeve të përcaktuara në vendimin e formës së prerë.

Përsa më sipër, Gjykata vlerëson se zyra e përmbarimit Tiranë, si organi kompetent i ngarkuar me zbatimin e vendimit të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë, nuk ka ushtruar kompetencat e përcaktuara nga ligji për zbatimin e vendimit dhe, për rrjedhojë, ka cenuar të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së.

3. Lidhur me pretendimin e kërkuesit për caktimin e gjobës

Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, dënimin me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë të subjektit të interesuar, në rast moszbatimi ose pengimi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata vlerëson se pretendimi i parashtruar më sipër nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit kushtetues. Në referim të nenit 81, pika 4 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, caktimi i gjobave në rast moszbatimi të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ose pengimi i zbatimit të tyre është kompetencë e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

Nga sa më sipër, pretendimi i kërkuesit është haptazi i pabazuar dhe, për rrjedhojë, kërkuesi nuk legjitimohet të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues për këtë pretendim.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash:

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.120, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Vitore Tusha, Admir Thanza

Anëtare kundër: Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

Jam kundër mendimit të shumicës për arsyet e mëposhtme:

1. Kërkuesi Dimitri Peitsidis ka bashkëjetuar me shtetasen RJ në Republikën Greke. Në vitin 2000 e sipërpërmendura ka lindur një djalë, të cilin kërkuesi e ka njohur si të vetin nëpërmjet një akti

noterial. Gjykata Njëanëtarshë e Selanikut, nëpërmjet disa vendimeve të ndryshme, i ka atribuar kujdesin prindëror të dy prindërve biologjikë të të miturit dhe ka përcaktuar mënyrën dhe kohëzgjatjen e vizitave të të miturit te secili nga prindërit.

2. Në vitin 2008 shtetësja RJ është larguar nga shteti grek, duke marrë me vete dhe të birin e mitur. Kërkuesi ka kallëzuar rrëmbimin e fëmijës pranë autoriteteve policore greke, të cilat kanë kontaktuar Interpol Tiranën, për të bërë të mundur gjetjen e vendndodhjes së të miturit. Pasi është vërtetuar fakti se i mituri ndodhej në Tiranë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit të Tiranës për të bërë të mundur njohjen e vendimeve të sipërpërmendura të Gjykatës Njëanëtarshë të Selanikut. Gjykata e Apelit të Tiranës ka pranuar kërkesën dhe më pas ka nxjerrë urdhrin e ekzekutimit, për zbatimin e këtyre vendimeve.

3. Përmbartuesi ka hasur vështirësi serioze për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës së Apelit të Tiranës, për arsye se vendimi i njohjes i jepte fuqi vendimit të Gjykatës së Selanikut, e cila i vendoste takimet në një tjetër hapësirë, pra i vendoste në rezidencat përkatëse të prindërve në Selanik.

4. Në rastin konkret, mendoj se akti juridik, i cili rregullon të drejtat e prindërve për të bërë të mundur ushtrimin e kujdestarisë ndaj fëmijëve të tyre dhe për të vendosur për vendbanimin e këtyre të fundit, është Konventa “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”, ratifikuar me ligjin nr.9446, datë 24.11.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”.

5. Në nenin 2 të ligjit të sipërpërmendur përcaktohet: “Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 6 të Konventës, autoriteti qendror për përmbushjen e detyrave të kësaj Konvente është Ministria e Drejtësisë.”

Preambula e Konventës së sipërpërmendur përcakton:

“Vendet nënshkruese të kësaj Konvente, tërësisht të bindura se interesat e fëmijëve janë të një rëndësie të veçantë në çështjet që lidhen me kujdestarinë e tyre, duke dëshiruar mbrojtjen ndërkombëtare të fëmijëve nga pasojat e dëmshme të largimit ose mbajtjes së tyre të padrejtë dhe për të krijuar procedura që sigurojnë kthimin e tyre të menjëhershëm në shtetin e banesës së tyre të përhershme, si dhe për të siguruar mbrojtje për të drejtat e kontaktit, kanë vendosur të lidhin një konventë për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme.”

6. Neni 1 i Konventës përcakton :

“ Qëllimet e kësaj Konvente janë:

a) të sigurojë kthimin e shpejtë të fëmijëve që largohen ose mbahen pa të drejtë në shtetin kontraktues;”

Për sa më sipër mendoj se ligji i zbatueshëm për t’i siguruar kërkuesit të drejtat e kontaktit me fëmijën, është Konventa e sipërcituar. Në këtë rast nuk mund të zbatohet procedura e përgjithshme e njohjes së vendimeve civile të autoriteteve të huaja, pasi jemi para një situatë juridike të veçantë, e cila ka si qëllim të vetin interesin më të mirë të të miturit dhe ky interes nuk mund të disponohet nga kërkuesi, i cili edhe pse ka denoncuar rrëmbimin pranë autoriteteve policore greke më pas ka zgjedhur një procedurë tjetër për të vënë në vend të drejtat e veta. Në bazë të parimit “*lex specialis derogat lex generali*” duhet të zbatohet pikërisht ligji nr.9446, datë 24.11.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.”

7. Kërkuesi i ka pasur të gjitha mundësitë që të shfrytëzojë mjetin juridik të ofruar nga Konventa, duke vënë në lëvizje Ministrinë e Drejtësisë, për të mundësuar kthimin e fëmijës në shtetin grek dhe ushtrimin e të drejtave të kontaktit sipas dispozitave të vendimeve të Gjykatës Njëanëtarshë të Selanikut dhe, në këtë kuptim, ai nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike para se të vëjë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

8. Në qoftë se do t’u referohemi argumenteve të shumicës, mendoj se çështja objekt shqyrtimi është më komplekse se çështjet e tjera të marra në shqyrtim nga kjo Gjykatë, me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosëkzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

9. Vendimi i Gjykatës Njëanëtarshë të Selanikut, që i ka njohur kujdesin prindëror të dy prindërve biologjikë të fëmijës së mitur, si dhe ka përcaktuar modalitetet dhe kohëzgjatjen e vizitave, është marrë në kushte dhe rrethana të tjera, kur, si kërkuesi, i ashtu dhe shtetësja shqiptare RJ banonin në Republikën Greke. Menjëherë pas këtij vendimi shtetësja RJ është larguar në Republikën e Shqipërisë, duke marrë me vete dhe fëmijën e mitur. Kërkuesi, krahas kallëzimit për rrëmbimin e fëmijës, ka bërë dhe kërkesë pranë Gjykatës së Apelit të Tiranës për njohjen e vendimit të gjykatës

greke dhe më pas nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit, të cilat janë pranuar.

10. Nga materialet e dosjes gjyqësore dhe asaj përmbartimore rezulton se me gjithë vullnetin e organeve përmbartimore, ekzekutimi i vendimit ka qenë objektivisht i pamundur, çka e ka detyruar përmbartuesin gjyqësor që, në marrëveshje me palët, të ndryshojë modalitetet e takimeve të përcaktuara në vendimin gjyqësor. Ndonëse me këtë veprim përmbartuesi ka arritur të realizojë takimet e kërkuarit me fëmijën e tij, në disa raste ka cenuar interesat e këtij të fundit, duke e shkëputur nga procesi mësimor në një kohë që përparësi janë dhe duhet të jenë në çdo rast mbrojtja e interesave të fëmijës së mitur.

11. Problemi që shtrohet për diskutim në këtë rast përsëri është i lidhur ngushtë me legjitimitimin e kërkuarit, në kuptim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Sipas këtij neni, kërkuari është i detyruar të shterojë të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Mendoj se edhe nga këndvështrimi se si e trajton këtë çështje shumica, kërkuari nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe, për rrjedhojë, duhej vendosur rrëzimi i kërkesës.

12. Për të arritur në këtë përfundim mjafton t’i referohemi Kodit të Familjes të Republikës së Shqipërisë, konkretisht dispozitave që bëjnë pjesë në kreun “Pasojat e zgjidhjes të martesës për fëmijët” (nenet 154-160). Në nenin 159 të këtij Kodi thuhet shprehimisht: “Vendimi lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore mund të ndryshohet në çdo çast nga gjykata, me kërkesën e njërit prej bashkëshortëve, një të afërmi ose prokurorit.” Kërkuari i kishte të gjitha mundësitë që, duke shfrytëzuar këtë rregullim juridik, t’i drejtohej përsëri gjykatës për mbrojtjen e të drejtave të tij në mënyrën më të mirë të mundshme.

13. Nga ana tjetër, mungesa e një rregullimi juridik adekuat që krahas subjekteve të përmendura më lart në nenin 159 të Kodit të Familjes, çështjen ta vinte në lëvizje në gjykatë edhe përmbartuesi ligjor, e ka detyruar këtë të fundit të kërkojë zgjidhje alternative, në pamundësi objektive për të përmbushur detyrimet që buronin nga vendimi i gjykatës

14. Një vendim gjyqësor objektivisht i pazbatueshëm rrezikon të mbetet i tillë edhe pas këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, në qoftë se kërkuari nuk do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për shterimin e mjeteve juridike, të ofruara nga legjislati shqiptar si më sipër. Në të kundërt, vendimi i shumicës mund të krijojë një shqetësim të ri lidhur me efektivitetin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Anëtar: Vladimir Kristo